

## **AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Le Box"**

Me date 12/01/2020, mbështetur në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare' I /ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nenhigjore, në cilësinë e Ortakëve themelues:

- 1. Znj.Fabjola Cali, shtetase shqiptare, e datelindjes 04-02-1995, lindur në Pogradec dhe banuese ne Tiranë, Rruga "Todi Shkurti", shtepi private, person madhor me zotesi juridike per te vepruar dhe me Nr.personal J55204029V.**
- 2. Znj. Paskalina Cali, shtetase Shqiptare, lindur me 10-10-2001 ne Pogradec dhe banuese në Rruga "Todi Shkurti" Banese private,Tirane, person madhor me zotesi juridike per të vepruar, mbajtëse e leternjoftimit me Nr. 034485038 dhe Nr. personal K160100325S.**

Deklarojnë se kane vendosor te nënshkruajne këtë kontratë themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar (me poshtë refereruar si Shoqeria), me termat e meposhtem:

### **Neni I Emërtimi**

Shoqeria emërtohet "Le Box" SH.P.K. Emertimi i shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

### **Neni 2 Selia**

Selia zyrtare e shoqerisë ndodhet në Tiranë, Rruga 'Pjeter Budi, Zona Kadastrale 8190, nr.pasurie 7/3, ZRPP. Shoqeria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si ne Shqiperi dhe jashtë saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri të tjera.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqerise do te jetë pa afat, duke filluar prej dates së regjistrimit te saj në Regjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qëndres Kombëtare të Regjistrimit Tiranë. Ky afat mund të ndryshohet nje ose me shume here, me vendim të Asamblese së Ortakëve.

### **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

1.Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Tregti me pakicë të kompozimeve me cokollata dhe lule natyrale dhe kutive te kartonit.

Shoqëria mundet të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Te gjitha veprimtaritë e pershkuara me sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj

## **Neni 5**

### **Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqindmije) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) kuota kapitali i ndarë në:
2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) kuota kapitali i ndarë në:
  - Znj. Fabjola Cali 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetmije) lekë.
  - Znj. Paskalina Cali 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetmije) lekë.
3. Kuotat e kapitalit janë të nënshkuara dhe të paguara. Neni 6

Kuotat e Kapitalit themeltar

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtme:

- Znj. Fabjola Cali ka kontribuar në para në shumën 50.000 (pesëdhjetmije) Lekë
- Znj. Paskalina Cali ka kontribuar në para në shumën 50.000 (pesëdhjetmije) Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

- Znj. Fabjola Cali është zotëruese e 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetmije) Lek ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Znj. Paskalina Cali është zotëruese e 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetmije) lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **Neni 7**

### **Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008

"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" I ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizike, qofshin këta edhe Jo ortak të cilet emrohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme.
3. Administratori i parë i shoqërisë është znj. Fabjola Cali shtetase Shqiptare, lindur në Pogradec lindur në Pogradec dhe banuese në Tiranë, Rruga "Todi Shkurti", shtëpi private, person i madhur me zotësi juridike për të vepruar dhe me Nr.personal J55204029V.
4. Mandati i administratorit fillon me datë 12/01/2021 dhe mbaron me datë 12/01/2026 me të drejtë për të rizgjedhur.

Ai do të ndjehet të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

#### **Neni 9**

#### **Të tjera**

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **Neni 10**

#### **Kundërshtimet**

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose me shumë ortakëve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë midis të interesuarëve për të zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### **Neni 11**

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "LeBox" SH.P.K.**

**FABJOLA CALI**

**PASKALINA CALI**